

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**KOMUNËN KODËR, THUMANË, KRUIË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Kodër, Thumanë, Krujë** me objekt: *“Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fondet publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimit e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, etj”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 84, datë 14.07.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 310/6, datë 14.7.2014, i ka rekomanduar z. Hamdi Pasha Kryetar i Komunës, zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.** Komuna Kodër Thumanë të marrë masa në lidhje me zbatimin e procedurave në ngritjen e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me kërkesat e ligjit nr 10296, datë 08.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”* si dhe shkresën e Ministrisë së Financave nr. 6082, datë 16.03.2011 *“Mbi hapat që duhen ndjekur nga njësitë publike mbi impletimin e këtij ligji”*.

**Menjëherë**

**2.** Komuna Kodër Thumanë për të gjithë prokurimet me vlerë të vogël të parashikuar në buxhetet vjetore për blerje mallrash apo kryerje shërbimesh të dërgojë pranë APP-së Regjistri i Parashikimit dhe Realizimit të tyre, në zbatim të VKM nr.1, datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, i ndryshuar.

**Vazhdimisht**

**3.** Komuna Kodër Thumanë të njoftojë zyrtarisht të gjithë punonjësit e larguar nga puna, të dorëzojnë me procesverbal të rregullt të gjithë dokumentacionin në arkivë ose punonjësve të cilët i kanë zëvendësuar ato.

**Menjëherë**

**4.** Nga Komuna Kodër Thumanë të pasqyroj në dokumentet e organizimit të tenderit llogaritja e fondit limit dhe e kostos për vlerat limit të kontratës publike pasi këto të dhëna kanë qëllim klasifikim të kontratës sipas kufijve monetare, planifikimin e sakte të fondeve dhe publikimin e tyre.

**Vazhdimisht**

**5.** Komuna Kodër Thumanë të organizoj dhe të kërkojë që të marrin pjesë punonjësit në kurse kualifikimi për përgatitjen e procedurave të prokurimit dhe vlerësimit të ofertave, me synim përmirësimin dhe ngritjen e shkallës së kualifikimit.

**Vazhdimisht**

**6.** Komuna Kodër Thumanë të kryej inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të zbatimit të kontratave të tenderave të realizuara në vitet 2012 dhe 2013, në zbatim të ligjit nr.9154, datë 6.1.1993 *“Për arkivat”*.

## **Deri Shtator 2014**

7. Komuna Kodër Thumanë të marrë masa për bllokimin e vlerës së garancisë së Kontratës ndaj Operatorëve ekonomik ekonomik “G...” shpk dhe “A...” Internacional SHPK, deri në riparimin e difekteve konstatuar në zbatimin e punimeve sipas kontratës së objektit “Asfaltim shtresë me rere bituminoze i rrugëve të fshatrave të Komunës Thumanë”, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar.

### **Brenda afatit të garancisë**

8. Nga ana e Sektorit të Tatim Taksave, për 59 subjektet të cilat nuk kanë paguar detyrimet për vlerën 3,596,848 lekë sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur raportit të auditimit të merren masat vijuese:

Të bëhen njoftim vlerësimet, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, të veprohet si më poshtë:

1.1. - Tu dërgohen Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

1.2. -Ti dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, vendosja e barrës siguroese (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit (për pasurinë e paluajtshme), kjo bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, dhe konkretisht në nenin 91.

1.3 -Në rast se subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, pasi tu vendosen masa administrative (gjobë në masën 25% të detyrimit sipas nenet 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, të kërkohet kallëzim penal në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, pikës 130-132 të UMF nr. 24, datë 02.09,2008 ”Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar dhe ligjit dhe Kodit Penal, neni 181, -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

## **Deri Gusht 2014**

9. Sektori i Tatim Taksave të Komunës Kodër-Thumanë, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të pa likuiduara të debitorëve deri më datën 31.12.2013 në vlerën 9,194,700 lekë, përkatësisht; për taksën e tokës, banesave dhe pastrimit.

### **Deri Gusht 2014**

10. Komuna Kodër-Thumanë, të marrë masat për arkëtimin e detyrimit në shumën 425,180 lekë ndaj 9 subjekteve që ushtrojnë aktivitet të pa licencuara, në të kundërt të vazhdohet me shkallëzimin e marrjen e masave vendosje gjobë në masën 25.000 lekë, sipas nenit 112 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat tatimore”, mbyllje aktiviteti dhe në rast mos arkëtimi nga ana e tyre e detyrimit të kryhet konfiskimi i materialeve në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe ligjin nr. 9920, datë 10.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 41, sipas Aneksit nr. 2, “listës personave debitorë të cilët nuk janë regjistruar në QKR, deri më datën 31.12.2013”, bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

### **Deri Gusht 2014**

11. Sektori i TatimTaksave të kryej inventarin e dosjeve të 62 subjekteve, që ushtrojnë aktivitete në Komunën Kodër- Thumanë, ti përditësojë e plotësojë me dokumentacionin e nevojshëm si, njoftim detyrimi, Dokumenti i Pagesës së detyrimit, Gen-Planet apo planimetritë për taksën e ndërtesave, Akt-konstatimet apo Akt-verifikimet për mbylljen e aktivitetit, të konfirmuara dhe nga Policia e Komunës, në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat tatimore në R.SH”, neni 29, - Dosja e detyrimeve tatimore, pika 1.

### **Deri Gusht 2014**

12. Sektori i Tatim Taksave ti dërgoj Zyrës së financës listën e debitorëve për detyrimet fiskale në fund të 2 viteve 2012 dhe 2013, me qëllim regjistrimin si debitorë, llogaritjen e

kamat vonesave dhe ndjekjen ligjore të tyre.

#### **Deri Gusht 2014**

**13.** Sektori i Tatim Taksave tu kërkoj subjekteve plotësimi dhe depozitimi në zyrën e taksave, të deklaratës qarkullimit, në zbatim të nenit 113 për mbajtjen e librave të xhiros dhe për mos deklarimin në afat të gjobiten subjektet në masën 10.000 lekë, në zbatim të nenit 117 të ligjit, nr. 9920 datë 19.05.2008” Për Procedurat tatimore”, i ndryshuar

#### **Deri Gusht 2014**

**14.** Sektori i Tatim Taksave dhe Policia e komunës të hartoj paketa me llojet dhe masën e gjobës dhe t’i propozohet për miratim Këshillit të Komunës, të vendosë për çdo shkelje të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, siç përcaktohet në shkronjën (a) të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 6 “Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative”.

#### **Për çdo vit buxhetor**

**15.** Sektori i Tatim Taksave i Komunës Kodër-Thumanë, të aplikoj masë me gjobë, në zbatim të nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat Tatimore” për pagesën e vonuar të kësteve të detyrimeve, ndaj subjekteve të cilët nuk zbatojnë afatet e përcaktuara sipas tremujorëve,.

#### **Vazhdimisht**

**16.** Sektori i Tatim Taksave i Komunës, të kryej ndalesat në listë pagesat e punonjësve të administratës të cilët deri më datën 30.11.2013, të cilët nuk kanë paguar taksën e tokës dhe banesës për vitet 2012-2013, për vlerën prej 764,004 lekë, respektivisht: 36 punonjës së administratës së komunës, 16 anëtarë të Këshillit të Komunës dhe 10 Kryepleq të fshatrave, sipas *Aneksit B, bashkëlidhur Raporti Auditimi.*

#### **Menjëherë**

**17.** Komuna Kodër-Thumanë të marrë masa për arkëtimin e debitorëve të krijuar gjatë vitit 2012 dhe 2013, për mos pagesën e faturave të ujit të pijshëm nga 187 abonentë familjarë në vlerën prej 1,071,000 lekë, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 236, datë 10.05.1993 ”Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë”, ndryshuar me VKM nr. 96, datë 21.02.2007 dhe udhëzimit nr. 03, datë 28.07.2004 të ish-MPVD “Për administrimin e ujit të pijshëm”, Pika 1,

#### **Menjëherë**

**18.** Komuna Kodër-Thumanë, të rihvillohen procedurat e përzgjedhjes së punonjësve të Policisë, duke zbatuar kriteret e urdhrit të përbashkët të MPVD nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe MRP, nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të Komunës”, pikat 4 dhe 5 ku përcaktohet se: asnjë punonjës i policisë bashkiake dhe i komunës, nuk vendoset në detyrë pa kaluar në formim në Akademinë e Policisë së Rendit sipas programit të miratuar për këtë qëllim.

#### **Menjëherë**

**19.** Kryetari i Komunës Kodër Thumanë të marrë masa që inspektorët e INUV pa arsimin përkatës të zëvendësohen me inspektorë me arsimin e duhur të cilët të jenë në përputhje me kërkesave të ligjit nr. 9780 datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” neni 11 “Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit ndërtimor urbanistik”.

#### **Menjëherë**

**20.** Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor (INUV), të marrë masa në bashkëpunim me zyrën e planifikimit të territorit, të evidentojë ndërtimet pa leje, duke aplikuar gjoba ndaj subjekteve ndërtuese të kundër ligjshme, me qëllim mbajtjen nën kontroll administrimin dhe zhvillimin e territorit.

#### **Vazhdimisht**

**21.** Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor vendor të merren masa dhe të nisen veprimet për prishjen e ndërtimeve të pa ligjshme, në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” me ndryshime, neni 5 pika “d” “dh”.

**Menjëherë**

**22.** Lidhur me dy gjobat e aplikuara sipas Vendimit nr. 5 date 06.06.2012 ne masën 200.000 leke dhe Vendimit nr. 6 date 12.06.2012 ne masën 700.000 leke, nga INUV Thumanë, ndaj shoqërisë “M...” për kundërvajtjen administrative, mospërputhje të objektit me kërkesat e lejes së ndërtimit e të projektit, ndryshime të përmasave, zënie të tokës pronë “shtet” e komunës, dhe për shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit, të merren masat ligjore :

a- Juristja e komunës Kodër Thumanë, të ndjekë të gjithë shkallët e gjyqësorit për të dy gjobat në fjalë, të bëj ankimin e vendimeve përkatëse brenda afateve të përcaktuar në ligj, të marrë pjesë në të gjitha seancat.

b- INUV Thumanë, pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe pasi të bëhet arkëtimi i plotë i gjobave, në bashkëpunim me policinë e komunës, të detyrojë subjektin “Millis Brick” të kthej në gjendjen e mëparshme sipërfaqet e dëmtuara apo uzurpuar për qëllime shfrytëzimi për lëndë të parë për fabrikën e tullave, për këtë rast të vërë në dijeni edhe INUK Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, duke i çuar rastin për shqyrtim së bashku me dokumentacionin përkatës.

**Menjëherë**

**23.** Komuna Thumanë të nisë procedurat e aplikimit për regjistrimin e pasurive në ZVRPP Krujë të transferuara me VKM nr. 454, datë 6.5.2009, VKM nr. 202, datë 21.02.2008, në përputhje me kreun IV nenin neni 18 ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, ”Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, neni 18- Dokumentacioni i transferimit, dhe me pikat 1, 2 të nenit 45 të ligjit nr. 33/2012. “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**Menjëherë**

**24.** Komuna Thumanë, të kryejë inventarizimin fizik dhe të përfshijë vlerën në pasqyrën përkatëse të evidencës kontabël zërin “toka, troje, terrene” në bilancet përkatës e cila të pasqyrohet në rreshtin 10, llogaria 210, të pronave të transferuara me VKM nr. 454, datë 6.5.2009, VKM nr. 202, datë 21.02.2008, pasi të ketë përfunduar regjistrimin e pasurive në ZVRPP Krujë, në zbatim të Kreut II neni 7 pikat 1-2, Kreut III neni 12, neni 18 pika 1 të ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” *si dhe në zbatim të pjesës (I), pikat 2, 5, 6, 7, 8, 9 a- b-c, pikat 10, 12, 13, pjesës (III) pikat 26, 28, pjesës (IV) pikat 73, 74, 75 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*

**Vazhdimisht**

**25.** Komuna Kodër Thumanë, në të ardhmen të marrë masa dhe të kryejë procedurat administrative, bazuar në nenin 116, pika “c” të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Për Kodin e Procedurës Administrative”, për deklarimin të pavlefshëm të 9 kontratave për dhënie toka me qera personave për aktivitet biznesi dhe shfrytëzimi për periudhën nga viti 2006-2013, për kontratat e lidhura, si më poshtë:

**a-** Kontrata me subjektin N.P., datë 14.6.2011, sipërfaqe toke 500 m<sup>2</sup>, pjesë përbërëse e pasurisë 9/I/I me sipërfaqe totale 359.130 m<sup>2</sup> e zërit kadastral inproduktive, ndodhur në fshatin Derven Kodër Thumanë.

**b-** Kontrata me subjektin "A..." Sh.A, datë 18.2.2009, të sipërfaqes 262.5 m<sup>2</sup>, ndodhur pjesërisht në pronën nr. 457, zona kadastrale nr. 2182 në kodër Thumanë, e llojit inproduktive në juridiksion dhe pronësi të komunës, dhe pjesërisht në pronën nr. 488, zona kadastrale nr. 2182 në kodër Thumanë, e zërit kadastral "Kullotë", me sipërfaqe nga 196 m<sup>2</sup>, ndodhur pjesërisht në pronën nr. 499, zona kadastrale 2182 në kodër Thumanë, e zërit kadastral "Pyll", ndodhur pjesërisht në pronën nr. 191, zona kadastrale nr. 1247 Borizanë.

**c-** Kontrata me subjektin "M..." sha, datë 3.11.2006, me objekt dhënien me qira të një sipërfaqe toke prej 1600 m<sup>2</sup>, ndodhur në Derven, parcela nr. 316, pjesë territoriale e komunës Thumanë. Në kontratë nuk është e përcaktuar për çfarë nevojash vihet në dispozicion kjo pronë.

**d-** Kontrata me subjektin "A...", datë 3.4.2006, me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup> për vendosjen e BTS masa, aksesoret e saj, gjenerator antena etj dhe 650 metra lineare (ml) që do të shërbejë si rrugë kalimi për tek BTS, sipërfaqe këto pjesë përbërëse e sipërfaqes 35 ha, pasuri e paluajtshme në pronësi shtetërore, ndodhur në Borizanë Thumanë, zona kadastrale nr. 1475, prona numër 9/1/1.

**e-** Kontrata me z. S. X., datë 23.4.2012 për dhënie në përdorim të një sipërfaqe 6.2 ha, "pyje" me numër prone 289, vendndodhja "Hudhra e Plakut", ngastra nr. 12

**f-** Kontrata me z. Gj.S., datë 23.4.2012, me objekt dhënie në përdorim të një sipërfaqe 0.9 ha, "pyje" me numër prone 296, ndodhur "Kodra Jak Ndreca" me ngastra nr. 25.

**g-** Kontrata me z. P.U., datë 23.4.2012, me objekt dhënie në përdorim të një sipërfaqe 1.00 ha, "pyje", me numër prone 272, vendndodhja "Ura e Trenit" me ngastra nr. 37.

**j-** Kontrata me z. A.V., datë 23.4.2012, me objekt dhënie në përdorim të një sipërfaqe 0.7 ha, "pyje" me numër prone 2294, vendndodhja "Tek Vathet" ngastra nr.27.

**i-** Kontrata me z. Astrit Vathi, datë 23.4.2012 me objekt dhënie në përdorim të një sipërfaqe 0.2 ha, "pyje" me numër prone 294, vendndodhja "Tek Vathët" ngastra nr.27.

#### **Menjëherë**

**26.** Komuna Kodër Thumanë, në të ardhmen, të marrë masa që kontratat para se lidhen të shqyrtojnë dhe miratojnë në këshillin e Komunës, në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.3.2004, neni 32, shkronja (ë), detyrat e këshillit bashkiak ose komunal, *ku parashikohet se: "Këshilli i komunës miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve"*.

#### **Vazhdimisht**

**27.** Kryetari i komunës Kodër Thumanë, në të ardhmen të nxjerr aktin administrativ për krijimin dhe funksionimin e bordit të dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara, të ndjekë procedurat dhe përgatisë dokumentacionin dhe të lidhë kontratat sipas përmbajtjes dhe formës ligjore, në zbatim të *udhëzimit nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara"*.

#### **Vazhdimisht**

**28.** Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, (ZMMT) të zbatojë detyrimin për ndjekjen e kontratave të qerave të tokave të pandara, në zbatim të VKM nr. 121, datë

17.02.2011”Mënyra e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe bashki” , Kreu IV, pika 2, shkronja c).

#### **Vazhdimisht**

**29.** Komuna Kodër Thumanë të inventarizojë, të identifikojë gjendjen fizike e juridike , të marrë nën administrim dhe të kërkojë në rrugë ligjore të ardhurat nga përdorimi i paligjshëm dhe zaptimi i pasurive nga persona të tretë dhe ato jashtë funksioni të pasurive të llojit troje, ndërtesa, objekte në pronësi të Komunës, transferuar me VKM nr. 454, datë 6.5.2009 “Për miratimin e listës së përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen, në pronësi ose përdorim në komunën Kodër Thumanë, të qarkut Durrës” , të përfundojë procesin e regjistrimit në ZVRPP Krujë, të njoftojë personat të cilët kanë kryer zënien apo posedimin në mënyrë të kundërligjshme, për kërkimin e dëmeve dhe të ardhurave të munguara nga zaptimi i paligjshëm, në zbatim të VKM nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, sipas aneksit (a), tabelat nr. 1-2-3-4-5-6-7-8-9, të Raportit Përfundimtar të Auditimit

#### **Menjëherë**

**30.** Komuna Kodër Thumanë duke qenë se nuk mund të garantojë efektivitetin, qëndrueshmërinë, eficientën, profesionalizmin dhe përgjegjshmërinë në procesin e planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit të territorit, nisur nga fakti që nuk posedon burimet e nevojshme njerëzore dhe monetare, për implementimin dhe realizimin e hartimit dhe miratimit të instrumenteve vendore të planifikimit dhe integritit / përputhshmërisë së tyre me instrumentet kombëtare të planifikimit, të ushtrojë mundësinë e delegimit të kësaj kompetence ose lidhjes së një marrëveshje, me këshillin e qarkut Durrës, ose njësisë vendore më të afërt, në përputhje me seksionin (III) nenin 15, nenin 16 të ligjit nr. 10119 me dt 23,4,2009 “Për planifikimin e territorit”, me ndryshimet.

#### **Menjëherë**

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

-Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, nga Komuna Kodër Thumanë të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat në vlerën **2,389,785** lekë si më poshtë:

**1. Për vlerën 70,000 lekë**, në ngarkim të punonjësit F.T., për pagë të dhënë për vitin 2012 e 2013, në kundërshtim me VKM nr.553, datë 11.08.2011, i ndryshuar.

#### **Menjëherë**

**2. Për vlerën 143,105 lekë**, në ngarkim të operatorit ekonomik “A...” shpk për moszbatim të pikës 2, të kontratës nr.645, datë 27.07.2012 dhe nr.512/1, datë 24.06.2013 “Për blerje Gazoil”.

#### **Menjëherë**

**3. Për vlerën 1,924,680 lekë**, në ngarkim të punonjësit G.K. me detyrë ish Kryetar Komune, detyrim ky i vendosur Komunës Thumanë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, për ti

paguar shoqërisë “Qira” shpk për 2 amendamente shtesë me nr. 411/1, datë 09.03.2009 dhe nr. 60/1, datë 03.11.2011, amendamente këto fiktive.

**Deri më 30.09.2014**

**4. Për vlerën 252,000 lekë**, për 5 persona, konkretisht: Gj.S. në vlerën 25.200 lekë, S.X. në vlerën 173.600 lekë, P.U. në vlerën 28.000 lekë, A.V. në vlerën 5.600 lekë, A.V. në vlerën 19.600 lekë, nga mosparashikimi i tarifave përkatëse në kontratat e lidhura, e cila është përlllogaritur mbi bazën e lidhjes nr. 2 kategoria Pyjet e ulëta, shkurre dhe kullota, kolona 11 e VKM nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.20010 veprim në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 16.05.2007 *shfuqizuar me udhëzim nr. 1, datë 18.7.2012* “Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore, të pandara”, Dispozitat e veçanta, *ku përcaktohet se: Pagesa e qirasë kryhet çdo fund tremujori, në masën 25% të shumës së qirasë vjetore. (vlera të cilat nuk janë kontabilizuar si debitorë).*

**Deri më 30.09.2014**

## **C. MASA DISIPLINORE**

-Mbështetur në kreun IV, neni 11, germa “e” dhe “ç” dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale tip, i rekomandojmë Kryetarit të Komunës, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore:

### **a. “Vërejtje me shkrim”**

**1. Z. G.D.** me detyrë ish përgjegjës i Zyrës së Financës

-Për mos zbatim të pikës 2 shkronja c, kreu VIII i VKM nr. 1 datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik, në zbatimin e kontratave, për blerje karburanti për vitet 2012- 2013 me një efekt financiar në dëm të buxhetit të shtetit në vlerën 143.105 lekë.

- Për mos përfshirjen në librin e inventarit kontabël të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara vlera të konsiderueshme të aseteve trajtuar: Toka, troje, terrene që lidhen me sipërfaqet e objekteve arsimore, social-kulturore, administrative, rrugëve, shesheve, veprat kullosore, pyje etj. Mungon inventarizimi fizik dhe përfshirja e vlerës në pasqyrën përkatëse të evidencës kontabël i zërit “toka, troje, terrene” me strukturën ligjore përkatëse në mënyrë ekstra kontabël, mosveprim ky në kundërshtim me ligji nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për kryerjen dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” i ndryshuar, me VKM nr. 532, datë 31.10.2002 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qark dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë”, si dhe me: Kreun II Neni 7 pikat 1,2 Kreu III neni 12, neni 18 pika 1 të ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar

**2. Zj. E.C.**, me detyrë juriste e komunës.

-Për mos zbatim të pikës 2 shkronja c, kreu VIII i VKM nr. 1 datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik, në zbatimin e kontratave, për blerje karburanti për vitet 2012- 2013 me një efekt financiar në dëm të buxhetit të shtetit në vlerën 143.105 lekë.

- Për mos apelim brenda afatit ligjor, në gjykatën e apelit të Tiranës, të vendimit nr. 541. datë 22.11.2013 të gjykatës së rrethit gjyqësor Krujë, brenda afatit ligjor me efekt financiar në dëm të buxhetit në vlerën 1.964.680 lekë

- Për mos regjistrim në ZVRPP Krujë, të pronave transferuara me VKM nr. 454, datë 6.5.2009, VKM nr. 202, datë 21.02.2008, , në kundërshtim me kreun IV nenin 13, neni 18 ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, me pikat 1, 2 të nenit 45 të ligjit nr. 33/2012.

- Për mos ndjekje të kontratave, ku është dhënë toke bujqësore me qera 4 personave, me sipërfaqe prej 3.458.5 m<sup>2</sup>, pa i regjistruar më parë në ZVRPP në kundërshtim me nenin 678 të Kodit Civil.

- Për mos miratim të kontratave në Këshillin të Komunës, veprim në kundërshtim me neni 32, shkronja (ë) të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me: ligjin nr. 9208, datë 18.3.2004, neni 32, shkronja (ë) detyrat e këshillit bashkiak ose komunal.

**3. Z. S.H.** me detyre inspektor i pyjeve.

**4. Zj. S.M.** me detyrë përgjegjëse e ZAMT.

Për mos regjistrim në ZVRPP Krujë, të pronave transferuara me VKM nr. 454, datë 6.5.2009, VKM nr. 202, datë 21.02.2008, , në kundërshtim me kreun IV neni 13, neni 18 ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, me pikat 1, 2 të nenit 45 të ligjit nr. 33/2012.

Për mos ndjekje të kontratave, ku është dhënë toke bujqësore me qera 4 personave, me sipërfaqe prej 3.458.5 m<sup>2</sup>, pa i regjistruar më parë në ZVRPP në kundërshtim me nenin 678 të Kodit Civil.

Për mos miratim të kontratave në Këshillin të Komunës, veprim në kundërshtim me neni 32, shkronja (ë) të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me: ligjin nr. 9208, datë 18.3.2004, neni 32, shkronja (ë) detyrat e këshillit bashkiak ose komunal.

Për mos ndjekje të kontratave, ku në 5 raste nuk është përlllogaritur mirë vlera e qerasë dhe si e tillë nuk është derdhur detyrimi në vlerën 252.000 lekë, shumë e cila përbën dëm ekonomik, të cilën e përlllogaritëm mbi bazën e lidhjes nr. 2 kategoria “Pyjet e ulëta , shkurre dhe kullota, kolona 11 e VKM nr. 391, datë 21.6.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.20010. veprim në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 16.05.2007 *shfuqizuar me udhëzim nr. 1, datë 18.7.2012.*

Për mos ndjekje të kontratave, ku është dhënë në 5 raste, shfrytëzim sipërfaqe pyjore, në kundërshtim me: nenin 45 të ligjit nr. 33/2012, me: Nenet 83, 144, 193, 197, 826, 827 të kodit civil, miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, ndryshuar me ligjin nr. 8536, datë 18.10.1999 dhe nr. 8781, datë 3.5.2001.

Për mos vënie në efincë, në moslidhje kontratash qiraje për të dy vitet **2012- 2013**, në shumën 1.503.645.600 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e komunës, llogaritur me nivelin e qirasë së truallit, sipas pikës (III) 1 (një). Pika a, paragrafi 4 (katër), 8 (tetë) pika c, të VKM nr. 529, datë 8.6.2011 në kundërshtim, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, *Në kundërshtim me : Pjesën (I), pikat 2, 5, 6, 7, 8, 9 a- b-c, pikat 10, 12, 13. Pjesa (III) pikat 26, 28. Pjesa (IV) pikat 73, 74, 75 Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* në kundërshtim me: Kreun II, Neni 4, neni 10, pika 1, shkronjat, a,b,c,c, d, dh, e,ë, pika 2 shkronjat a, b,c. Kreu III, neni 12, neni 14 pika 1, neni 21 pika 1 shkronjat ë, f. Kreu V, neni 17, shkronjat a, b, c të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004.

**5. z. H.G.**, filluar punë më datë 01.8.2013, aktualisht në punë kryeinspektor.

Pasi, për 24 ndërtime pa leje, të kundërligjshme nuk është marrë asnjë vendim prishje, nuk është aplikuar as një gjobë, në kundërshtim me nenin 5 neni 12 dhe 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, - VKM nr. 862 datë 5.12.2007 Ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit” neni 82 pika 7 germa “i”, “ii”.

**6. Zj. N.Gj.** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Tatim Taksave

**7. Z. S.Gj.** me detyrë Inspektor pranë Sektorit të Tatim Taksave

**8. Z. B.D.** me detyrë Inspektor pranë Sektorit të Tatim Taksave

- Për mos arkëtimin e debitorëve të taksave të popullatës, pasi deri datën 31.12.2013 gjendja e debitorëve, për të 2 llojet e taksave të popullatës paraqitet në vlerën **9,194,700 lekë**, përkatësisht; për taksën e tokës në vlerën 6,481,200 lekë dhe taksën e banesave në vlerën 2,713,500 lekë.



- Edhe pse janë evidentuar 59 subjekte të cilët janë debitorë deri më datën 31.12.2013 në vlerën 3,596,848 lekë, nga të cilët 16 subjekte nuk kanë paguar taksat për 2 vite rradhazi, 2012- 2013 në vlerën 1,195,085 lekë, ndërkohë ndaj tyre nga punonjësit e taksave nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore si më poshtë:

- Nuk janë nxjerrë njoftim vlerësimit, bazuar në nenin 70 pika 3 “ E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH.

- Nuk janë marrë masa dhe nuk u janë dërguar Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

- Nuk është kërkuar kallëzim penal, në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, pikës 130-132 të udhëzimit Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09, 2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ligjit dhe Kodit Penal i R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, *-Mospagimi i taksave dhe tatimeve*. tatimore”.

- Ndaj subjekteve të cilët nuk kanë paguar detyrimet në afat, nuk u janë vendosur masa administrative (gjobë në masën 25% të detyrimit), sipas nenet 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar.

**9. z. N.R., me detyrë** Inspektor i Policisë së Komunës

-Nga ana e punonjësit të Policisë së Komunës, gjatë veprimtarisë së tij nuk janë zbatuar kërkesat e urdhrat të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003” dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të Komunës” .

-Ndërmjet policisë së komunës dhe zyrës së taksave së Komunës Kodër-Thumanë nuk ka këmbim informacioni zyrtar nëpërmjet zyrës së protokollit, por bashkëpunim verbal dhe nga punonjësit e policisë komunës nuk njihet gjendja dhe nuk dihej numri i subjekteve që ushtrojnë aktivitetet në komunën Kodër-Thumanë dhe si rrjedhojë nuk i është vendosur asnjë gjobë subjekteve që rezultojnë debitorë për periudhën 2 vjeçare 2012-2013.

#### **D. KALLËZIM PENAL**

**Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 310/7, datë 16.7.2014 kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë:**

**1. G.K. me detyrë ish- kryetar i komunës, dhe në cilësinë e ish-kryetarit të KRRT-së.**

**2. M.K. detyrë ish-përgjegjës i zyrës së urbanistikës, dhe në cilësinë e ish-sekretar i KRRT.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

*Shënim:* Auditimi është kryer nga audituesit Ramadan Zejnuni, Dorino Mece, Vasil Vane dhe Mirland cela, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**